

**INTERLOGISTIC shpk**

**Pasqyrat Financiare**

**Per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2020**

NIPT: K21605003M

Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9,  
Godine 3 kateshe

Hartuesi: Eriona KURTI

Administrator: Edmond Hido

**Permbajtje:**

<b>Informacion i përgjithshëm</b>	<b>i</b>
<b>1. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)</b>	<b>5</b>
<b>2. Politika kontabël të rëndësishme</b>	<b>7</b>
<b>3. Ndryshime ne poitikat kontabël të Shoqërisë</b>	<b>17</b>
<b>4. Menaxhimi i rrezikut financiar</b>	<b>20</b>
<b>5. Vleresimet dhe gjykimet e rëndësishme kontabel</b>	<b>27</b>
<b>6. Te drejta dhe te tjera te arketueshme</b>	<b>28</b>
<b>7. Mjete Monetare</b>	<b>29</b>
<b>8. Aktive Afatgjata Materiale</b>	<b>30</b>
<b>9. E drejta per te perdorur aktivet afatgjata materiale</b>	<b>31</b>
<b>10. Huamarrje</b>	<b>31</b>
<b>11. Detyrime per qiranë</b>	<b>32</b>
<b>12. Detyrime te pagueshme</b>	<b>32</b>
<b>13. Te ardhura te shtyra</b>	<b>33</b>
<b>14. Te tjera te pagueshme</b>	<b>34</b>
<b>15. Kapitali</b>	<b>34</b>
<b>16. Te ardhura nga veprimtaria e shfrytezimit</b>	<b>34</b>
<b>17. Mallra lende e pare dhe sherbime</b>	<b>35</b>
<b>18. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>35</b>
<b>19. Shpenzimet per personelin</b>	<b>36</b>
<b>20. Shpenzime dhe te Ardhura financiare</b>	<b>36</b>
<b>21. Tatim fitimi</b>	<b>37</b>
<b>22. Transaksionet me palet e lidhura</b>	<b>38</b>
<b>23. Shpjegime te tranzicionit ne SNRF</b>	<b>38</b>
<b>24. Shenime te tjera</b>	<b>43</b>
<b>25. Ngjarje pas datës se raportimit</b>	<b>44</b>

## **INTERLOGISTIC shpk**

### **Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

##### **Organizimi dhe aktiviteti**

Shoqëria "INTERLOGISTIC" sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ME DATE THEMELIMI 28 Mars 2020, me Selë në adresën: Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godinë 3 kateshe, Kashar, Tirane.

Në datë 31 Dhjetor 2020, Shoqëria zoterohej nga ortaku si më poshtë.

- Edmond Hido zoteron 100.00 % të kapitalit

Veprimtaria e shoqërisë "INTERLOGISTIC" shpk rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria ka një objekt të gjere aktiviteti si, tregtimi i mallrave ushqimor e industriale, transport mallrash, aktivitet në fushën e ndërtimit, investimeve etj.

Numri mesatar i të punësuarve për vitin 2020 ishte 314 të punësuar .

Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

##### **a. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Shoqëria ka aplikuar SNRF 15 dhe SNRF 9 që nga 1 Janar 2018.

##### **b. SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientet**

IFRS 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendësoi SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe interpretimet përkatëse. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen kur një klient merr kontrollin e mallrave ose shërbimeve. Përcaktimi i kohës së transferimit të kontrollit - në një moment ose përgjatë një kohëzgjatje - kërkon gjykim. Shoqëria ka aplikuar SNRF 15, që në datën e aplikimit fillestar (dmth. 1 Janar 2018) pa ndonjë efekt në periudhat krahasuese.

##### **SNRF 9 Instrumentet Financiare**

IFRS 9 parashton kërkesa për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontrata për të blerë ose shitur sendet jofinanciare. Ky standard zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja.

Si rezultat i miratimit të SNRF 9, Shoqëria ka miratuar ndryshime konsekuente në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, të cilat kërkojnë që zhvlerësimi i aktiveve financiare të paraqitet në një zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Qasja aktuale e Shoqërisë është të përfshijë zhvlerësimin e humbjeve nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2019 ose pas kësaj date:

**SNRF 16 Qirate**

SNRF 16 Qirate paraqet një model të vetëm kontabilizimi në bilanc për qiramarrësit. Një qiramarrës njihet një të drejtë për të përdorur aktivin që përfaqëson të drejtën e përdorimit të këtij aktivi dhe njëkohësisht përbën edhe një detyrim qiraje që lidhet me obligimin për të shlyer pagesat e qirasë financiare. Ka disa përjashtime opsionale për qiratë afatshkurtra dhe qiratë për mjete me vlerë të vogël. Kontabilizimi për qiradhënësin mbetet shumë i ngjashëm me standardin aktual – për shembull, qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative.

SNRF 16 zëvendëson udhëzuesit aktualë të qirasë duke përfshirë SKK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi në rast se një marrëveshje përmban një qira, KIC-15 Qiratë operative – Incentivat dhe KIC-27 Vlerësimi i substancës së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë.

**c. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara**

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë në periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020:

- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshimet në SNRF 3 me datë efektive 1 janar 2020
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 me datë efektive 1 janar 2020
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 me datë efektive 1 janar 2020
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar me datë efektive 1 Janar 2020

Standardet në dispozicion për përdorim të hershëm:

- Koncesione qiraje të lidhura me COVID-19 - Ndryshime në SNRF 16 me datë efektive 1 qershor 2020

**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

Efektive qe prej 1 Janarit 2021

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit me datë efektive 1 Janar 2021
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente - Ndryshimet në SNK 1 me datë efektive 1 janar 2022
- Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një investitori dhe ndërmarrjes së tij të përbashkët ose ndërmarrjes së përbashkët -Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28

**3. Politika kontabël të rëndësishme**

**3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë**

**a) Baza e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur per here te pare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Zbatimi i SNRF-ve është sipas Ligjit Nr. 25/2018 datë 01.01.2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 17, datë 16.01.2019.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

**b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

**c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në "Lek" e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

**d) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.

**3.2 Parimi i vijmësisë**

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit. ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike. parimin e kontabilitetit rrjedhes. konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise. i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

## INTERLOGISTIC shpk

### Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

### 3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

#### 3.3 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmben në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmben duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmben duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2019 dhe 2020 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
USD	100.84	108.64
EUR	123.70	121.77

#### 3.4 Aktivët afatgjatë materiale

##### i) Njohja dhe matja

Elementet e aktiveve afatgjatë materiale mbahen me kosto historike pakësuar zhvlerësimin e akumuluar (si më poshtë) dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë.

Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë përfshin kostot e materialeve dhe punën direkte, dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktivitetit si dhe rregullimin e vendit në të cilin janë vendosur dhe kapitalizimin e koston së huamarrjeve.

Në rastet kur elementet e një aktiviteti material afatgjatë kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato mbahen si aktive afatgjatë materiale më vete (komponentët kryesore).

##### ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjatë materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjatë njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

##### iii) Zhvlerësimi (Amortizimi)

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metoden zbritese të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

**4. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)****3.4 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Mobilje dhe orendi	Mbi vleren kontabel neto	20%

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale shqyrtohet dhe rregullohet nëse është e përshtatshme në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivi shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohet duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitimin ose humbjen e periudhës financiare.

**3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontohehen për të sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

**3.6 Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.7 Instrumentet financiare**

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentave financiarë dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, me përjashtim të atyre të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të cilat fillimisht janë të matura me vlerë të drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitimin ose humbjen.

##### **i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare**

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivitetet financiare: matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39, të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura për shitje. Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë në kontratat ku baza është një aktiv financiar në këndvështrimin e standardit nuk ndahen kurrë. Në vend të kësaj, instrumenti financiar hibrid si një i tërë vlerësohet për klasifikim.

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e pasiveve financiare.

Miratimi i SNRF 9 nuk ka pasur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të Kompanisë lidhur me pasivet financiare.

##### **i. Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

SNRF 9 zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura në SNK 39 me një model të humbjes së pritshme të kredisë. Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, humbjet nga kreditë njihen më herët se në SNK 39. Për aktivitetet në kuadër të modelit të SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi zakonisht priten të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme.

Për shkak të metodës së tranzicionit të zgjedhur nga Shoqëria në zbatimin e SNRF 9, si edhe faktit se SNRF po zbatohen për here të pare nga Shoqëria në këto pasqyra financiare, informacioni krahasues në të gjithë këto pasqyra financiare nuk është tërësisht riparaqitur për të reflektuar kërkesat.



### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.7 Instrumentet financiare (vazhdim)**

##### **ii. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)**

*Vlerësimi i humbjeve te pritshme per klientët individuale:*

Provizionimi i llogarive te arketueshme eshte matur per gjithë jetëgjatësinë e humbjeve te pritshme.

*Matja e humbjeve te pritshme:*

Humbjet e pritshme jane vlerësuar ne baze te mesatarizimit te probabiliteteve te parashikuara mbi humbjet nga llogarite e arketueshme.

Evidence se nje llogari e arketueshme eshte e zhvlerësuar përfshin te dhëna te vëzhgueshme si me poshte vijon:

- Vështirësi financiare te klientit;
- Nje thyerje e termave te ripageses se borxhit si psh ditët ne vonese;
- Ristrukturim i llogarive te arketueshme
- Mundesite qe ndoshta klienti do te kaloje ne falimentim;
- Zhdukja e nje tregu aktiv per mallrat qe tregon klienti qe do te shkaktonte vështirësi financiare.

Nëse, në një periudhë pasuese, shumata e humbjes nga zhvlerësimi është zvogëluar dhe zhvlerësimi mund të shoqërohet me ngjarje që ndodhin pas njohjes së zhvlerësimit (si një përmirësim në indeksin e kredisë), humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë ndryshohet duke rregulluar llogarinë rezervë. Shumata e ndryshimit njihet në të ardhura dhe shpenzime.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.8 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

#### **3.9 Njohja e të ardhurave**

Sipas SNRF 15 të ardhurat do të njihen në masën që është pothuajse e sigurtë se një kthim në sasinë e të ardhurave të akumuluar të njohura nuk do të ndodhë. Kështu e ardhura matet duke u bazuar në shumën e përcaktuar në një kontratë me klientin ose në listën e cmimeve të Shoqërisë. Shoqëria e njeh të ardhurën atëherë kur ajo transferon kontrollin mbi shërbimin ose mallin tek klienti.

Shoqëria do të njohë të ardhurat në një pikë në kohë që do të përfaqësohet nga momenti që klienti pranon shërbimet e ofruara nga shoqëria si edhe merr persipër rrezikun e këtij transferimi të shërbimeve, me supozimin se nuk do të ketë kthime të rëndësishme në këto shërbime.

**INTERLOGISTIC shpk****Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

**Shitjet e mallrave:**

Të ardhurat njihen atehere kur ajo transferon kontrollin mbi mallin tek klienti.

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi natyrën dhe kohën e përmbushjes së detyrimeve të performancës duke përfshirë termat dhe kushtet e pagesave të rëndësishme:

<b>Tipi i produktit/sherbimit</b>	<b>Natyrë dhe koha e përmbushjes së detyrimeve të performancës duke përfshirë termat dhe kushtet e pagesave të rëndësishme</b>	<b>Politikat për njohjen e të ardhurës</b>
Shitja e produkteve	Klientet përfitojnë kontrollin e produkteve kur ata marrin të mirat.  Faturat perkatëse gjenerohen në këtë moment në kohë.	Shoqëria e njeh të ardhurën atehere kur ajo transferon kontrollin mbi shërbimin ose mallin tek klienti.
Shitja e shërbimeve	Klientet përfitojnë shërbimin kur ata e marrin atë.  Faturat perkatëse gjenerohen në këtë moment në kohë.	Shoqëria e njeh të ardhurën atehere kur ajo transferon kontrollin mbi shërbimin ose mallin tek klienti.

Miratimi i SNRF 15 nuk ndikoi në kohën ose shumën e të ardhurave nga kontratat me klientët dhe aktivet dhe detyrimet përkatëse të njohura nga Shoqëria. Prandaj, ndikimi në informacionin krahasues është i kufizuar në kërkesat e paraqitjes së pasqyrave.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.10 Perfitimet e punonjesve Sigurim i detyrueshem shoqëror**

Kompania paguan vetem kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat përcaktojnë perfitimet e punonjesve që dalin në pension. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara.

#### **Pushimi vjetor i paguar**

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar lidhur me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjesve në periudhën.

#### **Skemat me kontribute të përcaktuara**

Një skemë me kontribute të përcaktuara është një skemë me perfitime të pas-punësimit në të cilat njesia ekonomike paguan kontribute fikse në një entitet të veçantë dhe do të ketë asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shumën tjetër. Detyrimet për kontributet në planin e pensioneve me kontribute të përcaktuara, të tilla si fondin e pensionit shtetëror të Shqipërisë, njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

#### **Perfitimet afatshkurtra**

Detyrimet për perfitimet afatshkurtra të punonjesve nuk vlerësohen mbi bazën e aktualizimit dhe shpenzohen kur sigurohet shërbimi i lidhur me to. Një detyrim njihet për shumën e pritshme për të paguar të perfitimeve afatshkurtra nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësit dhe nëse detyrimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

#### **Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës**

Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës janë të pagueshme kur marrëdhënia e punës është ndërprerë nga Shoqëria përpara datës normale të daljes në pension, ose kur një punonjes pranon të leje vullnetarisht punën në këmbim të këtyre perfitimeve. Kompania njih perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës duke demonstruar angazhimin e saj: për të ndërprerë punësimin e punonjesve aktualë në bazë të një plani formal të detajuar i cili nuk lejon inkurajimin e largimit vullnetar nga puna. Perfitimet nga nderprerja e marrëdhënieve të punës që janë të pagueshme pas më shumë se 12 muaj pas datës së raportimit skontojnë në vlerën aktuale.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.11 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre**

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë. duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

#### **3.12 Provizionet**

Një provizion njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe parashikohen flukse dalese mjeteve monetare për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të mjeteve monetare me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet specifike të detyrimit.

#### **3.13 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin. një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

#### **3.14 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë. së bashku me entitete që ata kontrollojnë. të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme . vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

### **3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**

#### **3.15 Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

### **4. Ndryshime në politikat kontabël të Shoqërisë**

Shoqëria aplikoi për herë të parë kërkesat e SNRF 16, Qirate duke filluar nga 1 Janari 2020.

#### **Politika kontabël e aplikueshme që prej 1 Janarit 2020**

Që në konceptimin e një kontrate, Shoqëria vlerësin nëse një kontratë përmban ose jo një qira. Një kontratë përmban një qira nëse kontrata jep të drejtën për të kontrolluar ose për të përdorur një aktiv për një periudhë kohe në shkëmbim të një çmimi. Për të vlerësuar nëse një kontratë përmban të drejtën për të kontrolluar ose për të përdorur një aktiv, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë sipas SNRF 16.

Kjo politike kontabël është aplikuar për të gjithë kontratat e qirasë me 1 Janar 2020.

#### **Shoqëria si një qiramarrëse**

Në fillim ose në modifikimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Shoqëria e alokon çmimin përkatës të qirasë.

Shoqëria njeh të drejtën për të përdorur aktivin dhe detyrimin e qirasë në fillimin e kontratës së qirasë

#### **4. Ndryshime të rëndësishme në politikën kontabël të Shoqërisë (vazhdim)**

##### **Politika kontabël e aplikueshme që prej 1 Janarit 2020 (vazhdim)**

E drejta për të përdorur aktivin matet fillimisht në kosto, i cili përmban pagesat e qirasë, plus ndonjë kosto direkte të mundshme që lidhet me veninë në punë të aktivit.

E drejta për të përdorur aktivin me pas amortizohet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së qirasë. Në vijim e drejta për të përdorur aktivin, zvogëlohet periodikisht për ndonjë humbje të mundshme në vlerë, ose për ndonjë rrimatje të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në fillim të kontratës së qirasë, të cilat janë të skontuara me normën e interesit të huamarrjes së Shoqërisë.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### **Politika kontabël e aplikueshme përpara 1 Janarit 2020**

Për kontratat e qirasë të lidhura përpara 1 Janarit 2020, Shoqëria përcaktoi nëse këto kontrata përmbanin një qira apo jo duke vlerësuar sa më poshtë:

- Nëse përmbushja e kontratës varej nga e drejta për të përdorur ndonjë aktiv; dhe
- Nëse kontrata jepte të drejtën për të përdorur një aktiv. Një kontratë e jep të drejtën për të përdorur një aktiv nëse plotësohet sa më poshtë vijon:
  - Blerësi ka aftësinë ose të drejtën për të vepruar me aktivin nderkohe që kontrollon atë;
  - Blerësi ka aftësinë ose të drejtën për të kontrolluar aksesin fizik në aktiv.

## **5. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Manaxhimi i rrezikut financiar është një element i rëndësishëm në aktivitetin e Shoqërisë. Rreziqet kryesore me të cilat përballë Shoqëria janë ato që lidhen me rrezikun e tregut, i cili përfshin rrezikun e çmimit, të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit, rrezikun e kredise dhe rrezikun e likuiditetit.

### **5.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Politikat e Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë, menaxhojnë rreziqet me të cilat përballë Shoqëria, të përcaktojnë kufijtë e rrezikut, të vendosin kontrolle për të mbikqyrur riskun në kufijtë e përcaktuar dhe të sigurojnë përmes monitorimit që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda ketyre kufijve. Politikat dhe procedurat për manaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe paraqitjen e praktikave të perditesuara.

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim të ngushtë me mbikqyrjen e strukturave të manaxhimit të riskut ka përgjegjësi të plote për mbikqyrjen e kuadrit të manaxhimit të riskut, mbikqyrjen e manaxhimit të rreziqeve kryesor dhe rishikimin e politikave dhe procedurave të tij të manaxhimit të rrezikut sikurse miratimin e transaksioneve të rëndësishme dhe me shumica të konsiderueshme.

Si faktorët e brendshëm ashtu edhe ato të jashtëm janë identifikuar dhe manaxhuar përmes strukturës organizative të Shoqërisë.

### **5.2 Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Rreziku i tregut vjen nga ekspozimi i kompanisë ndaj normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe elementeve të tjera të cilat janë në ndikim të drejtperdrejtë të ndryshimeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e qëndrueshmërisë së çmimeve në treg.

Objekti i manaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm.

## **5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **5.2 Rreziku i tregut (vazhdim)**

*Flukset monetare dhe rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit*

Rreziku i normes se interesit eshte rreziku qe ndryshimi ne normat e interesit mund te shkaktoje luhatje ne te ardhurat e Shoqerise ose ne vleren e portofolit te investimeve.

Te ardhurat e Shoqerise dhe flukset monetare operative jane pothuajse te pavarura nga ndryshimet ne normat e interesit te tregut pasi Shoqeria nuk ka aktive financiare te cilat mbartin interes. Ndryshimet ne normat e interesit ndikojne kryesisht huamarrjet dhe huadheniet me norma interesi te ndryshueshme, duke ndryshuar flukset e ardhshme monetare. Drejtimi i Shoqerise nuk ka nje politike zyrtare te percaktimit te shumave te dhena ose te marra hua me norma interesi fikse ose te ndryshueshme. Megjithate, ne kohen e huamarrjeve te reja drejtimi perdor gjykimin e tij per te vendosur nese nje norme interesi fikse ose e ndryshueshme do te ishte me e favorshme per Shoqerine gjate periudhes deri ne maturim.



**INTERLOGISTIC shpk**

**Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

**5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.3 Rreziku i kreditit**

Rreziku i kredise eshte rreziku qe nje pale ne nje instrument financiar te shkaktoje nje humbje financiare ndaj pales tjetere duke deshtuar ne shlyerjen e detyrimit dhe vjen kryesisht si pasoje e llogarive te arketueshme te Shoqerise nga klientet e saj.

## **5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **5.4 Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që Shoqëria të ndesh vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Përfaqësimi i Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është që të sigurojë atë sa është e mundur se do të ketë gjithmone likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj kur ato kërkojnë si në kushte normale dhe jo normale pa shkaktuar humbje të papranueshme ose të rrezikojë demtimin e emrit të Shoqërisë. Shoqëria sigurohet vazhdimisht se ka mjete të mjaftueshme monetare për të paguar shpenzimet e pritshme operacionale, duke përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare. Kjo përjashton ndikimin e mundshëm të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen si psh. fatkeqësitë natyrore. Si më poshtë janë paraqitur maturitetet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare në datën e raportimit:

## **5. Manaxhimi i rrezikut financiar**

### **5.5 Manaxhimi i riskut të kapitalit**

Objektiva e Shoqërisë në lidhje me manaxhimin e kapitalit është ruajtja e aftësisë së saj për vijueshmëri të biznesit, në mënyrë që të mundësojë kthimin e përfitimeve të pritura nga aksionarët, e përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit e cila redukton koston e tij. Totali i kapitalit në administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabel plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si huamarrjet totale siç tregohet në bilancin kontabel minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqëria nuk ka kërkesa rregullatore të vendosura nga jashtë në lidhje me kapitalin.

### **5.6 Vlerësimi me vlerë të drejtë**

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën më të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushtet e tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e bazës së aktivitetit dhe të detyrimit.

#### **Instrumentet financiare të prezantuar me vlerë të drejtë**

Aktivitetet financiare të matura me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon aktivitetet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të disponueshme për aktivitetet dhe detyrimet e observuara, direkt (p.sh. çmimet) ose indirekt (të dhëna nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhëna mbi aktivitetet dhe detyrimet që nuk janë të bazuar në të dhëna të disponueshme nga observimi i tregut

**5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.6 Vlerësimi me vlerë të drejtë (vazhdim)**

Tabela në vijim tregon një përmbledhje të vlerave kontabël neto dhe vlerave të drejta të atyre aktiveve financiare dhe detyrimeve që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

**Te drejta dhe te tjera te arketueshme**

Te drejta dhe te tjera te arketueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre korrespondon me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturitetit afatshkurtër.

**Mjetet monetare**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat respektive kontabël si pasojë e maturimit të tyre më të shkurtër se tre muaj.

**Llogari dhe hua të pagueshme**

Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme dhe huave të pagueshme përafrohen me vlerën e tyre të drejtë.

## **INTERLOGISTIC shpk**

### **Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

#### **6. Vleresimet dhe gjykimet e rëndësishme kontabel**

Drejtimi i Shoqërisë ka përdorur gjykimin e tij në lidhje me një sërë vlerësimesh e supozimesh në lidhje me raportimin e aktiveve dhe detyrimeve dhe shpjegimin e aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara në përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SNRF. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vleresimet dhe supozimet e mëposhtme rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe ndryshimet njihen në periudhën në të cilën janë bërë vleresimet dhe në periudhat e ardhshme në të cilat këto vlerësime kanë ndikim.

##### **Pasiguria në gjykime**

###### **Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Shoqëria rregullisht teston për zhvlerësim të arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes së këtyre testeve shoqëria mer parasysh pagesat e rregullta të bera, pra debitori, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arketueshmerinë e pagesave nga instrumentat financiarë dhe një numër kriteresh të tjera të përdorura për të vlerësuar arketueshmerinë.

###### **Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen me shumën më të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

###### **Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme**

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritshme të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 9. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

7.